

In depth columns

DIGNITY

Written in resistance

Përmbledhje e 22 kolumnave të shkruara për Forumin për Ndryshime në Arsim.

©2026 Forumi për Ndryshime në Arsim
(Forum for Educational Change), National Endowment for Democracy (NED)

Publikues: FNA - Forumi për Ndryshime në Arsim

Kryeredaktor: Ardit Ramadani

Dizajni: Rina Abdullai

The publication "IN DEPTH columns" has been produced with the support of the National Endowment for Democracy (NED) as part of "Promoting Youth Engagement in Accountability of Public Institutions" project. Its contents do not necessarily reflect the official opinion of NED. Responsibility for the information and views expressed in this publication lies entirely with the author(s).

Universiteti 'ideal' në Maqedoninë e V: Si duket në sytë e një maturanti?

Gjersa po i afrohem përfundimit të vitit tim të fundit të shkollës së mesme në Maqedoninë e Veriut, pësha e zgjedhjes së universitetit të duhur po ndihet gjithnjë e më shumë. Vitet e mia në shkollën e mesme kanë qenë sfiduese, por edhe formuese. Duke ndjekur një shkollë me një numër të madh nxënësish, kushtet shpesh kanë qenë të kufizuara. Laboratorët ishin shpesh të pa pajisur dhe shumica e mësimeve mbeteshin vetëm në faqet e librave. Përvoja praktike ishte një luks që rrallë e përjetuam. Ky realitet më ka formuar perspektivën për atë që më duhet në një universitet—një vend ku njohuritë teorike kombinohen me aplikime praktike.

Një nga faktorët kryesorë që po shqyrtoj gjersa shikoj opsionet e mia është se sa mirë është i pajisur universiteti. Pas disa vitesh mësimi në një ambient ku burimet praktike ishin të kufizuara, dëshiroj të studioj në një universitet që ka laboratorë modernë, biblioteka të pajisura me materiale të fundit dhe hapësira që inkurajojnë bashkëpunimin dhe inovacionin. Këto burime jo vetëm që përmirësojnë mësimin, por gjithashtu ndihmojnë studentët të lidhin teorinë me praktikën.

Një tjetër kriter thelbësor për mua është reputacioni ndërkombëtar i universitetit. Një universitet që renditet mirë në nivel global ose rajonal tregon përkushtim ndaj cilësisë në arsim dhe kërkim shkencor. Të jesh pjesë e një universiteti me një njohje të tillë hap dyer për mundësi të ardhshme, si në Maqedoninë e Veriut, ashtu edhe jashtë saj. Për më tepër, këto universitete shpesh kanë partneritete me institucione të tjera, duke i ofruar studentëve mundësi për programe shkëmbimi dhe rrjete globale. Si dikush që ëndërron të jetë konkurrues në tregun ndërkombëtar të punës, ky aspekt është thelbësor. Po aq e rëndësishme është dhe zgjedhja e programeve që ofron universiteti. Kam një interes të madh për ekonominë dhe inxhinjerinë, prandaj më duhet një universitet që ofron jo vetëm këto fusha studimi, por edhe specializime brenda tyre. Një gamë e gjerë programesh më jep mundësinë të eksploroj drejtime të ndryshme dhe të zgjedh atë që përputhet më së miri me interesat dhe qëllimet e mia. Për më tepër, dua të jem pjesë e një universiteti që i jep përparësi kërkimit shkencor dhe inovacionit, duke krijuar një mjedis krijimtari dhe zbulimi.

Qasja mësimore dhe shërbimet për mbështetjen e studentëve janë gjithashtu të rëndësishme për mua. Duke ardhur nga një sistem ku mësimi ishte kryesisht teorik, dua një universitet që thekson një ekuilibër mes trajnimit praktik, praktikave profesionale dhe projekteve bashkëpunuese. Përtej akademikëve, shërbime të tilla si këshillimi për karrierë, mbështetja për shëndetin mendor dhe aktivitetet në kohë të lirë kanë një ndikim të rëndësishëm në një përvojë të plotë edukative.

Njëkohësisht, jam tërhequr nga universitete që krijojnë ndjenjën e një komuniteti të fortë dhe përkatësie. Dua të kaloj vitet universitare i rrethuar nga njerëz që më frymëzojnë, më sfidojnë dhe ndajnë dëshirën time për të mësuar. Një jetë studentore e gjallë, diversitet kulturor dhe mundësi për të marrë pjesë në organizata studentore apo iniciativa vullnetare janë faktorë që vlerësoj shumë. Përvoja të tilla mund të më ndihmojnë të rritem personalisht dhe të ndërtoj lidhje domethënëse me të tjerët.

Në fund të fundit, po kërkoj një universitet që përputhet me aspiratat e mia, por që gjithashtu më nxit të mendoj përtej tyre. Dua të jem pjesë e një komuniteti që jo vetëm më përgatit për një karrierë, por gjithashtu më jep vlera për mësim të vazhdueshëm, krijimtari dhe përgjegjësi. Zgjedhja e universitetit të duhur është më shumë se sa një zgjedhje emri në listë—është gjetja e një vendi ku mund të zhvillohem dhe të bëhem personi që aspiroj të jem.

BERIN MUHAMED

Studentët x Shteti: Sa e ndihmojnë njëri tjetrin?

Përkundër që të gjithë jemi koshient për vështirësitë me të cilat përballemi ne studentë në Maqedoninë e Veriut, duke filluar nga mos pasja e kushteve themelore për studim, gjithmonë, kur hapet debati – ‘të qëndrojmë në vend, ose të ikim për të kërkuar më mirë’, na thuhet të rrimë. Pasi, sipas tyre, shoqëria paska nevojë për ne dhe rrjedhimisht, ne jemi ata që me një shkop ‘magjik’ do të ndryshojmë gjendjen.

Po, shoqëria mbase ka nevojë për ne – por, a na pyet dikush neve, se për çfarë kemi nevojë ne? Rrallë. Për shembull, a e dini se në atë ‘botë’ që synojmë të ikim një ditë pjesa më e madhe e jona, përkundër mundësive për punë, studentët nuk paguajnë asnjë qindarkë ose shumë pak për transport publik, ushqim, vizita në muze dhe akomodim. Ne për disa prej këtyre jo vetëm paguajmë, por paguajmë njëjtë sa do të paguante një pronar kompanie me qindra të punësuar, pasi statusi ‘student’ nuk ju thotë gjë kompetentëve.

Të jesh student në Shkup do të thotë të udhëtosh falas me transportin publik, i cili, për hir të së vërtetës, është gjysmëfunktional ndërsa vitin e fundit shpesh herë jofunktional. Si ‘dhuratë’ nga shteti na u prezantua edhe shujta e subvencionuar, ose 140 denarë në ditë për ushqim të shëndetshëm, kështu të paktën quhet. Tash, sado qesharake që mund të tingëllojë, me 140 denarë në ditë nga ne kërkohet të ushqehemi, madje, të ushqehemi shëndetshëm.

Vini re; flasim për një realitet ku pjesa më e madhe e studentëve janë të papunë ndërsa shumica jetojnë në Shkup larg familjes së tyre. Në këto rrethana, problemi i vetëm i studentëve do të duhej të ishte provimi i radhës, dhe jo nëse do të mund t’ia dalin javës mbanë financiarisht, duke u mbështetur në ato pak ndihma nga shteti.

Maqedonia e Veriut idenë për shujtën e subvencionuar e mori nga Sllovenia, por jo ashtu siç duhet. Për shembull, në Slloveni, studentët vendas dhe ata të huaj që studionë atje, ju lejohet të kenë qasje në ushqime të subvencionuara, me subvencione shtesë për studentët që janë prindër, ata me aftësi të kufizuara dhe fëmijët veteranë të luftës. Çmimin e plotë të vaktit e cakton katereri dhe i zbritet subvencioni shtetëror, duke i lënë studentit të paguajë diferencën.

Familjarët shpesh herë i dëgjojmë duke na thënë se do të bënin gjithçka për ne, se ne jemi krenaria e tyre – dhe po, sado e vërtetë që mund të jetë kjo, neve si studentë nuk na pëlqen kur detyrohemi të bëhej 'barrë' për ata dhe t'i shohim duke paguar për arsimimin tonë. Por, përpos subvencioneve minimale, në vendin tonë është thajse e pamundur si student të gjesh punë që do të përshtatej, pasi mundësitë janë të vogla.

Për fund, pavarësisht se studentët në fund të ditës vendosin të qëndrojnë këtu, të bëjnë gjithçka ashtu siç duhet bërë, tentojnë të ndryshojnë e zhvillojnë shoqërinë dhe për krejt këtë, mbi supe mbajnë gjitha vështirësitë – lind pyetja, pse nga shteti trajtohem si barrë, dhe jo si prioritet?

SARANDA EMRULLAHU

Universitetet e Pluhurit dhe Plagëve

Në një vend ku reformat zakonisht fillojnë nëpër salla konferencash të shkëputura nga përvojat e atyre për të cilët supozohet se bëhen, ne guxuam të bëjmë diçka radikale: dëgjuam.

Në Maqedoninë e Veriut, arsimi nuk është një rrugë drejt mundësive, është një test qëndrueshmërie. Një diplomë këtu shpesh vjen me koston e mirëqenies, dinjitetit dhe në disa raste, edhe të shëndetit mendor.

Midis radhëve të politikëbërësve dhe ekspertëve, ishin studentët ata që bartnin të vërtetat më të rënda, jo përmes retorikës, por përmes rrëfimeve. Rrëfime për mëngjeset që nisnin në orën 05:00 me autobus nga Struga për në Shkup. Për pritjet në të ftohtë në terminalin e Manastirit, me një çantë të rëndë mbi supe dhe një gjendje shpirtërore edhe më të rëndë, me shpresën se arsimi mund të jetë ende një shkallë për të dalë nga stagnimi sistemik që kanë trashëguar.

Për studentët nga qytetet më të vogla, arsimi është një pelegrinazh. Udhëtimi i përditshëm drejt universiteteve në Shkup nënkupton orë të humbura në transport, vakte të anashkaluara, gjumë i shkurtuar dhe jokualitativ. Nuk është vetëm një sfidë akademike, është sfidë fizike dhe emocionale. Shumë prej tyre përballen me konvikte të pafinancuara, të tjerë me diskriminim mbi baza etnie, gjuhe apo gjendjeje ekonomike.

Mundësia është e monopolizuar gjeografikisht. Për studentët, universiteti nuk është një privilegj – është një sfidë logjistike për të mbjetur.

Ne e kthyem dritën kah këto fisura. Studentët folën jo vetëm për pengesat fizike, por edhe për ato psikologjike, ndjenjën e padukshmërisë në një sistem që shpërblen privilegjin dhe ndëshkon përkushtimin. Ata ndihen të përjashtuar nga proceset vendimmarrëse, realitetet e tyre zhbëhen në statistika, dhe e ardhmja negociohet pa ata në tryezë.

Universitetet në Maqedoninë e Veriut vuajnë nga kurrikula të vjetruara, mungesë trajnimi praktik, dhe profesorë që shpesh janë pengesë dhe jo udhërrëfyes. Provimet shpërblejnë memorizimin, jo të kuptuarit. Praktikat klinike shpesh janë “shiko, por mos prek”. Nuk ka mentorime, nuk ka praktika të paguara, nuk ka përgatitje për jetën reale. Ka vetëm presion.

"Fakulteti i mjekësisë të mëson si të kalosh provimet, jo si të bëhesh mjek." tha një studente.

"Prej nesh pritet të jemi gjithmonë të përgatitur mendërisht, fizikisht – pa marrë asnjë mbështetje emocionale apo monetare."

"Pjesa më e madhe e profesorëve flasin nga një lartësi e paaritshme, ata paraqesin një autoritet që ndëshkon dhe jo që të udhëheq në procesin e zhvillimit profesional."

"Jam një studente ambicioze, por sistemi arsimor në Maqedoninë e Veriut më bën vazhdimisht të dyshoj në aftësitë e mia akademike. Shpesh e pys veten: A jam vërtet e prerë për të bërë këtë rrugë? Por vazhdoj përpara, sepse më intereson."

Por sistemi nuk e kthen të njëjtën përkujdesje. Nepotizmi dhe klientelizmi janë të ngulitur thellë në institucionet akademike. Për studentët "e zakonshëm" bursat ndihen si lotari. Pozitat e asistentëve shpesh ndahen jo sipas meritës, por sipas lidhjeve. Studentët pa përkrahje familjare apo pa lidhje politike janë të braktisur, duke u përpjekur në heshtje.

Shumë fakultete, sidomos ai i mjekësisë, zgjasin me vite. Gjatë kësaj kohe, studentët nuk fitojnë asgjë. Puna me kohë të pjeseshme është pothuajse e pamundur për shkak të ngarkesës së studimeve, që do të thotë se shumica varen nga ndihma e familjes. Dhe për ata që nuk kanë atë mbështetje, sfida është pothuajse e papërballueshme.

"Nuk është aspak heroike të luftosh me studimet derisa të thyhesh. Sillemi sikur është, por nuk është," shkroi një studente. "Në fund të fundit, duhet të kemi mirëqenie të plotë emocionale dhe shpirtërore. Meritojmë ta jetojmë rininë, jo vetëm ta mbijetojmë atë."

"Ti duhet të lexosh gjatë gjithë kohës, ndaj të punosh është thuajse e pamundur. Kjo do të thotë që shumë studentë përballen me vështirësi financiare dhe varen totalisht nga familja; nëse janë aq me fat sa ta kenë atë mbështetje." tha një student tjetër.

Përballë gjithë kësaj, ajo që kultivon sistemi nuk është përsosja profesionale, sistemi prodhon studentë gjysmakë të nënshtruar; të duruar përballë një

neglizhence strukturore, stafit të nënpaguar dhe mungesës totale të rrjeteve të sigurisë sociale. Studentët ende jetojnë në konvikte të mykura, ndjekin mësim me libra të vjetruar, dhe shpenzojnë më shumë për transport sesa për ushqim.

Të jemi të sinqertë: sistemi aktual arsimor në Maqedoninë e Veriut nuk krijon mundësi, ai i mbron të privilegjuarit.

Kjo nuk është krizë studentore. Është dështim kombëtar. Arsimi në Maqedoninë e Veriut nuk të frymëzon dhe nuk të përgatit, ai të lodh dhe të paralizon.

Ajo që u nevojitet studentëve në Maqedoninë e Veriut nuk është mëshirë. Është ndryshim strukturor që përfshin:

- Kampuse të decentralizuara dhe të financuara mirë në gjithë vendin;
- Transport studentor falas ose i përbalueshëm;
- Konvikte të sigurta, të pastra dhe të jetueshme;
- Praktika të paguara dhe trajnime që vlejné;
- Profesorë që udhëzojnë, jo që frikësojnë;
- Një infrastrukturë e shëndetit mendor që nuk fillon dhe mbaron me "qëndro i/e fortë";
- Dinjitet akademik

Sepse nëse të rinjtë tanë më punëtorë dhe më të përkushtuar ndihen të padukshëm, të stërlodhur dhe të pa zë, atëherë sistemi nuk është i çrregulluar, ai funksionon pikërisht siç është ndërtuar: për të mbrojtur pushtetin dhe për të shpërblyer privilegjin.

Dhe ne po i humbasim. Nga lodhja. Nga migrimi. Nga dëshpërimi. Maqedonia e Veriut nuk mund të vazhdojë t'u kërkojë studentëve të mbijetojnë një sistem që refuzon të ndryshojë.

Ne u detyrohemi atyre më shumë sesa duartrokitje. Ne u detyrohemi reformë. Reformë të vërtetë, të dhimbshme dhe strukturore. Çdo gjë më pak është tradhti.

Hapësirat e treta dhe bençet e para

Stolet e qytetit kanë parë dhe dëgjuar gjithçka nga ne.

Pas shtatë orëve në shtëpinë e dytë, ç'kuptim do të kishte të ktheheshim tek e para? Pas së dytës vjen e treta, dhe kjo, për ne, ishte kudo gjendej ndonjë ulëse e lirë. Ato pranë lumit ishin veçanërisht atraktive — kishte më shumë për të parë nëpër rrugët e frekuentuara, më shumë për të diskutuar. Në ndonjëfarë mënyre, kjo ishte agora jonë, ku rriheshin tema kategorikisht të ndryshme: nga pudra te Pavlovi, brenda minutash.

Komentonim ngjarjet e ditës në gjimnaz me një seriozitet që do t'i skuqte faqet e shumë analistëve politikë. E ç'zgjidhje tjetër kishim, kur promovimet dhe shkarkimet ndodhnin mu pas cikleve zgjedhore? Profesorët bëheshin më të parehatshëm se kurrë, për një karrige më të mirë se ajo afër dërrasës. Djemtë dhe nipat e atyre që ishin dikush përshpëritnin më zëshëm: "Kjo është me këta, prandaj. Ai e ndërroi. Forumi rinor. A je me? Apo kundër? Ka punuar. Premtoi."

Bençi, siç e quanim ne me anglicizëm ulësen, veçmë ishte i joni. As duhej të na e premtonin në fjalime të stërzgjatura, as të na detyronin të mblidhnim vota vrap për të. Thjesht shtrydeshim aty, katër-pesë veta. Ndryshe nga ata, s'e kishim problem të ndanim karrigen e lavdishme. Pëllumbave shpesh u hidhnim më shumë patatina se ç'hanim vetë. Kuptohet — ndryshe nga ata.

Ndonjëherë ishim edhe gjykues, tallës, cinikë — siç dinë të jenë adoleshentët — por gjithmonë brenda kornizave të arsyes. Pavarësisht gjithçkaje, mbanim një korrektësi politike që favorizonte grupet e shtypura. Të rinjtë e njohin nga afër shtypjen, edhe më shumë nëse ndodh të jenë femra, dylbera, të varfër... gjëra që s'rekomandohen të jesh tek ne.

Kur kapeshin te lakuriqësia e nxënëseve, ne u kujtonim epshin e profesorëve. Historitë e këtyre lidhjeve i shihnim si keqpërdorim detyre dhe pedofili, jo si thashetheme intriguese. Ndryshe nga ata. Mësuam të drejtën në teori dhe padrejtësinë në praktikë. Na kryqëzonin për mungesa profesorë që mungonin në seancat e tyre gjyqësore, por ne i bënim dëm vetëm vetes — ndryshe nga...

Gjatë reshjeve, mbanim çadrat hapur. Nganjëherë na kërcisnin edhe dhëmbët, por vazhdonim. Kishim harxhuar të gjitha paratë dhe kaluar të gjitha kafenetë. Si s'patëm një kulm. Edhe ngrohje! Një tavolinë, si jemi ulur. Pse s'kemi kinema? Ka pasur, në Jugosllavi. Sa mirë. Sa keq. "Do e blejmë një shtëpi bashkë dhe do shikojmë filma." Në këtë ekonomi?

Nuk e dinim asokohe që po përshkruanim të ashtuquajturat "hapësira të treta". Këtu janë të rralla, si çdo gjë jashtë kthetrave elitare partiake — ose si vendet për t'u parkuar. Kur ekzistojnë, janë pre e tentativave për përvetësim nga po ato qarqe që s'kanë dhënë kokërr mund për to. Pas dështimit të lajkave, fillojnë shpifjet që kulmojnë me okupim. Kush do ta mendonte se udhëheqësia lokale mund të shtyhet me fuqitë imperialiste botërore? Inteligjenca izraelite do ishte krenare me ta. Po, e bënë "shtab rinor", nëse dyshuat. Kështu ndodhi me Space Tetova, hapësirën e renovuar nga ish-Radio Tetova e braktisur.

Para se ta qani me ligje, për fat të mirë Space 3.0 qëndron tek ish-shtypshkronja Napredok, falë punës së palodhshme të vullnetarëve ndërkombëtarë dhe vendas. Për kureshtarët që pyesin se çfarë bëhet aty? Gjithçka që donim te bençi. Diskutime, art, filma, koncerte... Jo nga ato që bënin partitë politike për inat të njëra-tjetrës. Ndodh edhe të ulesh dhe të shijosh momentin, pa u dashur të blesh diçka. Një hapësirë që sfidon monetizimin agresiv, hierarkinë e kotë dhe çdo çmënduri tjetër, shumë prej të cilave s'kemi as fjalë për t'i artikuluar, por na shpojnë në fyt kur përpiqemi t'i përbijmë.

Në sytë e konformistëve, të ndejturit në benç ose në hapësirë shpesh është "për njerëzit pa punë", sikur njeriu në gjendje të prehjes dhe reflektimit të jetë fyerje kundër vetë Zotit ose diçka. Në realitet, s'ka gjë më të natyrshme, më shekullore, sesa një grup njerëzish që rrijnë, hanë, pijnë, flasin, qeshin bashkë. Ku janë këto, është edhe puna — kurse puna jonë e parë, mbi të gjitha, është të jemi njerëz.

Herën tjetër që do uleni në benç, bluajeni këtë shkrim në kokën tuaj. En çajo osht ni pun.

SARA SAITI

Tragjedia e heshtjes kolektive

“Nuk ka asgjë më të fuqishme se sa një ide koha e së cilës ka ardhur” – shkruante humanisti i madh francez, Viktor Hygo, duke iu referuar forcës së pashmangshme të vullnetit për progres dhe zgjim shoqëror. Dy shekuj më vonë, kjo thënie vazhdon të mbetet po aq e vlefshme. Çdo ndryshim fillon me një ide. Me një revoltë të vogël. Me një pakënaqësi që mbartet gjatë, që grumbullohet në heshtje, derisa një ditë e zakonshme shpërthen papritur.

Ajo revoltë e brendshme, që për vite të tëra mbetet në fyt, të shfaqet në momentet më të thjeshta: në një mëngjes të zymtë me shi, duke pirë kafënë e mëngjesit, në autobusin e stërmbushur, apo kur nuk gjen çelësat e makinës ndërsa je me nxitim për në punë. Ka një çast në jetë kur kupton se kupa e durimit është mbushur deri në buzë – dhe millefi i akumuluar kërkon të marrë formë. Në atë çast, shprehja “mjaft më” nuk është më një akt i vogël zemërimi, por një shpërthim i domosdoshëm i ndërgjegjes.

Por a është vërtet aq i thjeshtë ky shpërthim!?

Në shikim të parë, po – por në realitet, ai kërkon një kusht të rrallë: guximin kolektiv për të mos heshtur.

Në rajonin tonë, këtë guxim po e tregojnë studentët në Serbi. Prej më shumë se një viti, mijëra të rinj çdo ditë protestojnë kundër regjimit autoritar të Aleksandar Vuçiqit, një pushtet i zhytur në krim dhe korrupsion. Me vendosmërinë e tyre, ata janë bërë zëri i rezistencës, duke e kaluar ndoshta provimin më të rëndësishëm të jetës.

Edhe pse protestat e tyre i përkasin politikës së brendshme serbe, jehona e këtij zëri rinor ka tejkaluar kufijtë. Dhe kjo ndodh për disa arsye të thella. Së pari, sepse ndryshimet më të mëdha në histori kanë nisur gjithmonë nga rinia. Nga ata që refuzojnë ta pranojnë realitetin si të pandryshueshëm. Së dyti, një rini e vetëdijesuar, me mendim kritik dhe ndjeshmëri shoqërore, është pasuria më e madhe e një vendi. Së treti, sepse te këta studentë shumë prej nesh shohim diçka që e kemi humbur: idealin, besimin në mundësinë e ndryshimit dhe ndjenjën e përbashkët të përgjegjësive.

Sepse në shoqërinë tonë kjo energji duket sikur është shuar. Rinia këtu është më e heshtur, më e lodhur, më e tërhequr në vetvete. Ka zgjedhur, ndoshta pa vetëdije, të ndëshkojë shtetin me heshtje. Por heshtja, në këtë rast, nuk është formë rezistence – është një lloj dorëzimi që i shkon për shtat pushtetit.

Edhe kur vendi tronditet nga tragjedi të mëdha, si ajo në ajo në spitalin modular në Tetovë, aksidentin në Bullgari dhe zjarri në diskotekën e Koçanit, reagimi shoqëror mbetet i zbehtë. Përtej disa ditëve zie dhe protestave simbolike, jeta vazhdon sikur të mos ketë ndodhur asgjë. Në një shoqëri normale, një ngjarje e tillë do të kishte përmbysur shtete, do të kishte rrëzuar qeveri dhe do të kishte vënë në lëvizje institucione dhe ndërgjegje. Këtu, ajo u përthith në rutinë – një simptomë e rrezikshme e mpirjes kolektive.

Kjo mungesë reagimi nuk është rastësi. Është pasojë e një procesi të gjatë zhgënjimi, ku idealet e dikurshme janë tretur në vorbullën e burokracisë, në pasigurinë ekonomike, në ankthin e përditshëm... Është rrjedhojë e një sistemi që për dekada ka mësuar të rinjtë të mos besojnë se zëri i tyre ka peshë. Por, një shoqëri që nuk dëgjon rininë e saj, është një shoqëri që humb të ardhmen. Një rini pa ideale nuk është thjesht një problem brezi – është një paralajmërim për shtetin. Sepse aty ku mungon ideali, mbizotëron apatia. Dhe aty ku mungon zëri i pakënaqësisë, pushteti s'ka më pse të frikësohet.

Në fund, gjithçka nis – siç thoshte Hygo – nga një ide. Një ide që mund të lindë në heshtje, por që në momentin e duhur, kërkon të marrë frymë. Detyra e brezit tonë është ta njohë atë çast, ta artikulojë dhe ta mbrojë – përpara se fjalët të kthehen në nyje të pazgjidhura në fyt.

TEUTA BUÇI

Anatomia e një klase të thyer

Në Maqedoninë e Veriut, kriza në sistemin e arsimit nuk është një sekret. Ajo është e dukshme në çdo ndërtesë fakulteti, në çdo amfiteatër të stërbushur dhe në çdo brez studentësh që hyjnë në universitet me ambicie dhe largohen me ankth.

Prej dekadash, sistemi po shembet në heshtje dhe kontribuesit kryesorë të këtij kolapsi qëndrojnë në krye të sallës mësimore.

Problemi nuk qëndron vetëm tek programet e vjetëruara mësimore apo tek mungesa e burimeve. Këto janë thjesht simptoma. Patologjia e vërtetë qëndron te prania e profesorëve joadekuatë, individë që mbajnë tituj akademikë, por jo integritet akademik. Profesorë që janë joprofesionalë dhe të papërgjegjshëm, të cilët megjithatë mbrohen nga institucionet që duhej t'i kishin disiplinuar.

Studentët në Maqedoninë e Veriut nuk janë të hutuar sepse u mungon disiplina.

Ata janë të hutuar sepse në rrugëtimin e tyre profesional udhëhiqen nga njerëz që kanë pushuar së mësuari prej kohësh.

Në shumë fakultete, siç janë ai i mjekësisë, juridikut, inxhinierisë, dhe shkencave shoqërore, ligjëratat mbahen nga shënime të zverdhura prej vitesh, të shkruara dekada më parë. Konceptet shpjegohen me arrogancë në vend të qartësisë. Pyetjet trajtohen si kërcënime.

Studentëve u kërkohet të kuptojnë materiale që nuk u janë shpjeguar asnjëherë, të cilat janë vështirë ose aspak të kuptueshme; tekste absurde, pa rrjedhshmëri dhe përplot gabime gjuhësore, që e bëjnë të mësuarit dhe të kuptuarit të pamundur.

Dhe kur nuk arrijnë t'i kuptojnë? Faji është i tyre.

Kjo kulturë krijon një brez të rinjsh përplot dyshime dhe pasguri ende pa e filluar karrierën e tyre. Prodhon profesionistë që hyjnë në tregun e punës duke u ndjerë të papërshtatshëm, sepse institucioni që i trajnoi, investoi vite për ta përforcuar këtë ndjenjë.

Qasja e shumë profesorëve nuk është thjesht joprofesionale, është abuzive. Sulmet verbale, presioni psikologjik, poshtërimi publik, komentet sarkastike gjatë provimeve dhe kërcënimet me nota janë normalizuar.

Në çdo institucion të çdo vendi të shëndoshë, kjo do të klasifikohet si sjellje e dënueshme. Në universitetet e Maqedonisë së Veriut, konsiderohet "vlerë" dhe "traditë".

Studentët e mësojnë herët se profesorë të caktuar mund t'i trajtojnë si të duan, pa u ballafaquar me pasoja. Ata mësojnë gjithashtu se nëse raportojnë abuzim, i njeiti nuk do të shqyrtohet. Ankesat zhduken. Vlerësimet injorohen. Administratat mbrojnë stafin e tyre, por asnjëherë studentët e tyre. Asnjë pasojë për ata që shkatërrojnë ambiciet e të rinjve në emër të autoritetit.

Prandaj, studentët pëshpërisin përvojat e tyre nëpër korridore, por kurrë nuk parashtrajnë një ankesë sepse e dinë se sistemi mbron autoritetin, jo integritetin.

Kështu riprodhohet një sistem i thyer: duke shpërblyer heshtjen dhe nënshtrimin dhe duke i ndëshkuar ata që guxojnë të ëndërrojnë dhe të flasin.

Sistemi arsimor po i dështon studentët, bashkë me të edhe ligji. Maqedonia e Veriut nuk ka zbatuar kurrë një mekanizëm funksional për vlerësimin e stafit akademik apo për trajtimin e ankesave të studentëve. Nuk ekzistojnë procese të mirëfillta disiplinore. Nuk ka mbikëqyrje transparente. Nuk ka organe të pavarura që i mbrojnë studentët nga dhuna akademike.

Si pasojë, profesorët e korrumpuar, pa etikë, joprofesionale dhe me prapavijë të dyshimtë, mbeten në pozitat e tyre, duke formësuar mijëra mendje me njohuri të vjetëruara, gjysmake dhe metoda abuzive.

Sepse produktet e këtij sistemi bëhen mjekët, juristët, inxhinierët, mësuesit dhe administratorët e vendit. Dhe kur universitetet e kthejnë frikën dhe poshtërimin në normë, kjo reflekton më vonë në mënyrën se si këta profesionistë veprojnë dhe marrin vendime.

Ajo me të cilën përballet sot Maqedonia e Veriut nuk është mungesa e talentit, por mungesa e mbështetjes. Studentët nuk janë konfuzë dhe të humbur sepse janë të paaftë. Ata janë të humbur sepse sistemi nuk i udhëzon.

Ajo që duhet të bëjmë ne është t'i kundërvihemi dhunës që fshihet pas gjuhës akademike, të luftojmë frikën që e definon çdo ndërveprim student-profesor, të flasim për largimin e heshtur të të rinjve të talentuar, ata që sistemi deshtoi t'i mbante, sepse ishte shumë i zënë duke i llastuar të privilegjuarit.

Dhe nëse reforma një ditë do të ndodhë, ajo nuk do të ndodhë duke hartuar projekte që do të ngelin në letër, as duke brohoritur slogane të stërpërdorura politike, por duke e konfrontuar arrogancën që sundon sallat tona të mësimi dhe duke ju kujtuar profesorëve se mësimdhënia nuk është vegël pushteti por akt përgjegjësie.

Reforma do të fillojë kur një student do të ketë lirinë të thotë “Nuk e kuptoj”, dhe në vend që të poshtërohet ai më në fund do ta marrë shpjegimin që e meriton.

Një klasë e thyer prodhon profesionistë të thyer. Dhe një vend i ndërtuar mbi profesionistë të thyer nuk mund të rrijë në këmbë.

BLERINA QAMILI

Kur kupton se universiteti mund të funksionojë krejt ndryshe

Pasi u diplomova në Universitetin e Evropës Juglindore këtu në Shkup, u gjenda sërish para një dileme: Nëse duhet ti vazhdoja edhe studimet pasdiplomike këtu, të kërkoja për mundësi shkollimi jashtë vendit, ose të kërkoja mundësi pune dhe kështu të rritesha profesionalisht. Duke i qenë se përvoja në universitet nuk më kishte përmbushur vendosa të kërkoj punë me shpresë se një ditë do të kem mundësinë të vazhdoj studimet jashtë vendit. Në vitin 2024 fitova një bursë të plotë për studime në Mbretërinë e Bashkuar përmes programit Chevening, një program me traditë mbi 40-vjeçare që ka mbështetur më shumë se 60,000 profesionistë të rinj nga e gjithë bota.

Në asnjë moment nuk dua të idealizoj sistemin arsimor në Mbretërinë e Bashkuar. Arsimi britanik ka probleme reale, ashtu si ai i vendit tonë ka merita të pamohueshme. Por pikërisht përplasja mes këtyre dy realiteteve më mësoi diçka thelbësore: arsimi është kultura me të cilën një shoqëri e trajton dijen dhe vendin që i jep studentit në këtë proces.

Profesori dhe autoriteti

Këtu jemi të formuar brenda një tradite ku profesori shihet si figura e pakontestueshme e autoritetit. Kam pasur profesorë fantastikë, por modeli i përgjithshëm prodhon një klimë ku pyetja ngjan si provokim dhe ku kritika shpesh interpretohet si mungesë respekti. Distanca mes profesorëve dhe studentëve është strukturore. Mësimi është proces i njëanshëm: studentit duhet të marrë, por rrallë i jepet hapësirë të kontribuojë.

Në Londër, për herë të parë pashë se marrëdhënia akademike mund të ndërtohet ndryshe. Profesorët, shpesh studiues të nivelit më të lartë në fushat e tyre, ishin kërkues por komunikonin me thjeshtësi, pranonin hapur kur nuk dinin diçka dhe, ndryshe nga këtu, nxisnin aktivisht debat. Nga një sistem ku duhet të kërkoja leje për të folur, u gjenda në një mjedis ku më pyesnin vetë se çfarë mendoja, duke iu drejtuar njëri-tjetrit me emër e jo me tituj. Kjo nuk është çështje sjelljeje; është ndryshim paradigme.

Unë e kalova një semestër duke e normalizuar tek vetja faktin se mentores time dhe profesorëve duhet t'u drejtohesha me emër e jo me tituj. Por nëse titulli nuk e jep autoritetin, atëherë nga çfarë ushqehet ai, nga hierarkia apo nga ajo se çfarë përcjell një profesor?

Ironikisht, përvoja më tregon se profesorë të përgatitur ka mjaft; ajo që mungon është kultura akademike që e trajton studentin si mendje të pranishme e jo si trup të heshtur në rreshtin e parë apo të fundit të klasës.

Vlerësimi i studentëve

Në sistemin tonë, mënyra se si vlerësohet studenti e shndërron mësimin në disiplinë dhe jo në kërkim. Nota shpesh shërben si mjet kontrolli, jo si mjet orientues, dhe frika nga gabimi bëhet pjesë e përditshme e procesit akademik. Në një mjedis të tillë, nuk ka shumë hapësirë për të testuar ide, sepse vëmendja përfundon tek presja e pika ku e vendon profesori dhe jo te thellësia e mendimit. Kur arsimit funksionon në këtë logjikë, ai krijon ndjekës të kujdesshëm dhe jo kritikë të mendimit.

Në Maqedoni, sukcesi shpesh përkufizohet nga aftësia për të transmetuar mendimin e profesorit me saktësi milimetrike. Provimi kthehet në një rit ku studenti teston kujtesën dhe jo kuptimin. Ndërsa në Mbretërinë e Bashkuar, vlerësimi ishte proces i zgjatur dhe i ndërtuar mbi ide. Ese, analiza, raporte dhe prezantime. Aty duhej të hulumtoje, të ndërtoje qëndrim dhe të mbaje përgjegjësi për mënyrën se si argumenton. Nuk të shpërblehej aftësia për të mësuar përmendesh, por mendimi kritik.

Problemi më i madh gjatë studimeve ka qenë të jem specifik. Duke ardhur nga një sistem ku duhet të dëshmosh se ke mësuar çdo ligjëratë, shpesh e gjeja veten duke shkruar gjatë për të treguar se "e di", dhe jo mjaftueshëm për të treguar se "kuptoj". Në këtë mënyrë, shumë detyra akademike shndërroheshin në një mision pothuajse të pamundur për t'u përmbushur brenda kufizimit të fjalëve që caktonin profesorët.

Mirëqenia studentore

Në Maqedoni, arsimit nuk është prioritet, e aq më pak janë studentet. Qeveria e ka prerë në heshtje buxhetin për standardin studentor për 7.3 milionë euro, dhe kjo do të kishte kaluar pothuajse pa u vënë re po të mos e kishte zbuluar Forumi për ndryshime në arsim. Ky vendim tregon se studentët nuk trajtohen si njerëz me nevoja reale për të mësuar dhe për t'u zhvilluar.

Në Britani, unë jetoja në Londër, një ndër qytetet më të shtrenjta në botë. Universiteti im çdo ditë ofronte mëngjes falas, dhe për vetëm rreth 200 denarë (3 pound), mund të haje drekë të bollshme e llojllojshme në mensën studentore. Kjo nuk është dhuratë, por vendim politik. Ne shpesh fshihemi pas faktit që universitetet publike janë me kosto shumë ulët por kjo nuk e nuk e ndryshon faktin se shteti britanik nuk e trajton sigurinë financiare si privilegj.

Duke qenë në kontakt edhe me studentë nga universitete të ndryshme në Britani, e kupton shpejt se universitetet atje funksionojnë si një ekosistem i organizuar rreth nevojave të studentit: hapësira studimi të qasshme, biblioteka që punojnë gjatë, mbështetje psikologjike, mentorim, klube dhe shoqata për çdo interes. Kryefjala e këtij mjedisi është diversiteti, secili është i pranuar pa dallim prejardhjeje, orientimi apo identiteti. Kjo qasje krijon kohezion social real dhe e shndërron universitetin në një hapësirë ku studentët jo vetëm studiojnë, por ndërtojnë qëndrueshmëri, vetëbesim dhe një ndjenjë të vërtetë përkatësie.

Përvoja ime në të dy vendet e bëri të qartë një dallim thelbësor: një universitet që e trajton studentin si partner funksionon; një universitet që e sheh si barrë ngec. Edhe në Maqedoni, ashtu si në Britani, punova në programe "puno dhe studio", por atje paga ishte reale dhe e menduar për jetën studentore, ndërsa këtu mbetjet simbolike. Atje universiteti më siguroi edhe një internship të shkurtër; këtu, megjithëse praktika është obligative, më duhej ta gjeja vetë sepse nuk kishte asnjë mbështetje institucionale.

Dallimi ishte edhe më i dukshëm te iniciativat studentore. Në Universitetin Westminster, me mbështetjen e zyrës së rektorit, arrita të realizoj edicionin e 14-të të iniciativës sime Tregime Pjeshkash, të fokusuar te gratë e diasporës ballkanike në Londër, për herë të parë jashtë rajonit, me të gjitha resurset e nevojshme të siguruara nga universiteti. Ndërsa gjatë studimeve në Maqedoni, edhe pse unë dhe kolegët morëm licencë ndërkombëtare për organizimin e një eventit TEDx në kuadër të universitetit, nuk patëm asnjë lloj mbështetjeje; përkundrazi, u përballëm me pengesa të vazhdueshme që e bënë të pamundur realizimin e tij.

Britania dhe Maqedonia tregojnë dy mënyra krejt të ndryshme të të menduarit për arsimin. Në Britani arsimit trajtohet si pjesë e infrastrukturës së shtetit, një investim strategjik që mbështetet me politika të qarta, resurse dhe një kulturë institucionale që funksionon. Në Maqedoni arsimit shpesh mbetet shërbim

formal, i paorientuar dhe i lënë pas dore, pa mekanizma që e mbajnë studentin të përfshirë dhe të mbështetur. Ky kontrast është i prekshëm në përditshmëri dhe tregon qartë se në cilin vend arsimi shihet si prioritet.

Ajo që del qartë është se arsimi i lartë përcaktohet nga marrëdhënia që universiteti ndërton me studentin. Aty ku ka besim, mbështetje dhe hapësirë për të menduar, arsimi të zhvillon dhe të hap rrugë. Aty ku mbizotërojnë frika, hierarkia dhe burokracia, arsimi vetëm të certifikon. Në thelb cilësia e një sistemi matet nga mënyra se si të lejon të mësosh, dhe pikërisht kjo mënyrë e dallon një sistem që funksionon nga një sistem që vazhdimisht dështon.

GUXIM NUHU

Rinia që nënshkruan pa e ditur çfarë humb

Një firmë. Një letër. Një kontratë e palexuar. Ka raste kur mjafton kaq për të humbur një të drejtë.

Shumë të rinj sot hyjnë në marrëdhënie pune, nënshkruajnë dokumente apo komunikojnë me institucione pa e kuptuar realisht se çfarë po pranojnë. Jo sepse nuk duan të dinë, por sepse askush nuk i ka mësuar. Pikërisht këtu fillon problemi.

Padituria juridike nuk është thjesht mungesë informacioni. Është dobësi. Dhe çdo dobësi në shoqëri, herët a vonë, shfrytëzohet.

E drejta nuk është pronë e juristëve. Ajo është mekanizmi që rregullon jetën e përditshme, në marrëdhëniet e punës, në kontratat dhe në raportet me institucionet publike. Megjithatë, për një numër të madh të rinjsh, e drejta mbetet e largët dhe shpesh e pakuptueshme.

Kjo mungesë njohurie ka pasoja konkrete. Një i ri nënshkruan një kontratë pa e lexuar dhe pranon kushte të pafavorshme. Një tjetër pranon të punojë pa kontratë, duke mbetur pa mbrojtje juridike. Në raste të tjera, mosrespektimi i afateve ligjore mund të çojë në humbje të pakthyeshme të së drejtës.

Këto nuk janë përjashtime. Janë situata që përsëriten çdo ditë.

Më shqetësuese është se shumë të rinj nuk e kuptojnë as që janë në një pozitë të pafavorshme. Padituria krijon një normalitet të rremë, ku padrejtësia pranohet dhe nuk kundërshtohet.

Në këtë boshllëk njohurie krijohet një varësi e panevojshme nga të tjerët, persona që pretendojnë të japin zgjidhje, por që jo gjithmonë veprojnë në interes të të rinjve. Kjo hap rrugë për keqinformim, manipulim dhe shpenzime të panevojshme për procedura që mund të kryhen thjesht dhe pa kosto.

Për këtë arsye, edukimi juridik bazik nuk është luks, por domosdoshmëri. Ai u jep të rinjve mundësinë të kuptojnë, të reagojnë dhe të mbrojnë veten.

Një i ri i informuar nuk frikësohet nga kontratat, nuk heziton të kërkojë sqarim dhe nuk pranon lehtësisht padrejtësinë.

Në fund, problemi nuk është vetëm se të rinjtë nuk i njohin të drejtat e tyre, por se kjo padituri krijon terren ku padrejtësia vepron pa pengesa.

Sepse një shoqëri ku të rinjtë nuk i njohin të drejtat e tyre, është një shoqëri ku padrejtësia nuk ka nevojë të fshihet, ajo thjesht vepron.

Autorja e kësaj kolumne është Elisa Murseli. Ajo është studente në Fakultetin Juridik të Universitetit të Evropës Juglindore dhe trajton tema që lidhen me ndërgjegjësimin juridik dhe të drejtat e të rinjve.

ELISA MURSELI

Si mund t'i shërojnë të tjerët, studentët që sistemi i la të pashëruar?

Nisja e hapave të parë drejt asaj që mund të bëhet karriera jote është ndoshta momenti për të cilin asnjë i ri nuk është vërtet i përgatitur, megjithatë është pikërisht kjo që pritet nga çdo student në ditën e parë të Universitetit. Çdo përvojë është e veçantë, por të gjithë fillojmë me të njëjtën dituri të heshtur: do të kërkojë kohë, përqendrim dhe sakrificë. Ajo çfarë askush nuk të thotë është sa shumë.

Shumë fakultete nuk kanë kampus, klasa të denja, pajisje të nevojshme apo kushtet bazë që do ta bënë suksesin të mundshëm. Studentët e mjekësisë janë të ngjeshur në laboratorë të vegjël ku eksperimentet shpesh kryhen vetëm një

herë, nga një demonstrues ose një student i vetëm, ndërsa të tjerët shikojnë sepse pajisjet nuk mjaftojnë për të gjithë. Pavarësisht se paguajnë shkollim dy herë në vit, bashkë me tarifa shtesë për "kostot e universitetit", dhe na thuhet të sjellim maskën dhe dorezat vetë, ngarkesa më e rëndë mbetet ajo mendore.

Në Maqedoninë e Veriut, të bëhesh mjek shihet si një rrugë fisnike dhe e sigurt, diçka që premtun respekt, stabilitet dhe qëllim. Por pas këtij ideali fshihet një realitet i ashpër: sistemi që trajnon mjekët e ardhshëm po i dështon ata shumë kohë para se të hyjnë ndonjëherë në profesion.

Studentëve u pritet të mbajnë një barrë të madhe akademike, megjithatë u jepet mbështetje minimale. Kurrikula të vjetruara, metoda të ngurta mësimdhënieje dhe një fokus i tepruar në memorizim lënë pak hapësirë për mendim kritik apo kuptim të vërtetë. Në vend që të trajnohen si profesionistë të aftë dhe të sigurt, shumë studentë bien në modalitetin e mbijetesës, duke studiuar jo për të mësuar, por thjesht për të kaluar provimet.

Mbështetja institucionale për shëndetin mendor është ose e dobët ose nuk ekziston fare. Lodhja, ankthi dhe stresi kronik nuk janë përjashtime, ato janë norma. E megjithatë këto vështirësi shpesh shpërfillen si pjesë e domosdoshme e udhëtimit. Universitetet rrallë ofrojnë këshillim të arritshëm, hapësira të sigurta apo edhe thjesht njohje se studentët po kalojnë kohë të

njohje se studentët po kalojnë kohë të vështira. Në një sistem që i përgatit njerëzit të kujdesen për të tjerët, mungesa e kujdesit për vetë studentët është e habitshme.

Problemi nuk ndalet brenda mureve të universitetit. Pagat e ulëta, mundësitë e kufizuara për specializim dhe politizimi i proceseve të punësimit krijojnë një ndjenjë pasigurie që nuk largohet lehtë. Shumë studentë mbeten duke i bërë vetes një pyetje të vështirë: a ia vlen e gjithë kjo?

Si pasojë, një numër në rritje i të diplomuarve të rinj po zgjedhin të largohen. Vendi investon vite në edukimin e tyre, dhe pastaj i humb në sisteme që ofrojnë kushte më të mira, respekt dhe mbështetje. Kjo nuk është vetëm humbje personale për studentët, është dështim kombëtar. Një sistem shëndetësor nuk mund të funksionojë pa profesionistë të motivuar, megjithatë vetë struktura që synon t'i prodhojë ata po i largon ata.

Ajo çfarë e bën këtë situatë edhe më shqetësuese është se sa e normalizuar është bërë. Vështirësia pritet. Lodhja mbahet gati si medalje nderi. Por ky normalizim fsheh diçka më të thellë, një sistem që mbështetet në qëndrueshmërinë e studentëve në vend që të përmbushë përgjegjësinë e tij për t'i mbështetur ata.

Nëse Maqedonia e Veriut dëshiron të ndërtojë një sistem të fortë kujdesi shëndetësor, duhet të fillojë duke u përballur me mënyrën si i trajton mjekët e saj të ardhshëm. Reforma nuk është opsion, është domosdoshmëri. Kjo do të thotë arsim i modernizuar, investim në shëndetin mendor, mundësi të drejta punësimi dhe një mjedis ku studentët mund të kenë sukses pa sakrifikuar veten.

Sepse kur një vend i dështon studentët e mjekësisë, në fund të fundit i dështon pacientët e tij.

SARANDA EMRULLAHU

Me autorë sekretë nuk bëhet ligj publik

“Nëse më garantojnë se nuk do më padisin për shkak se i kam zbuluar”.

Kështu pati deklaruar Vesna Janevska, ministrja e Arsimit dhe Shkencës në Maqedoninë e Veriut kur u pyet se kush janë autorët të cilët e kanë hartuar Propozim-ligjin për arsim të lartë, i cili po përcillet me shumë bujë, ku academia dhe sektori civil kanë kërkuar tërheqjen e ligjit.

Kjo deklaratë e ministres nuk është vetëm e çuditshme por është alarmante, sepse për herë të parë po na thuhet, në mënyrë të tërthortë, se transparenca mund të jetë e rrezikshme për pushtetin.

Pikërisht ky është problemi, sepse nuk po flasim për një dokument privat, por për një ligj publik me pasoja direkte për studentët, profesorët dhe gjithë sistemin arsimor.

Një ligj që prek interesin publik nuk mund të ketë autorë anonimë, sikur të ishte ndonjë roman me autorë sekretë.

Megjithatë, kjo është ajo që pikërisht po ndodh.

Emrat e një ligji kaq të rëndësishëm për publikun vazhdojnë të mbeten sekret, ndonëse tani më dihen në opinion, por Ministria e Arsimit vazhdon të mos i konfirmojë zyrtarisht.

Refuzimi për t'i konfirmuar zyrtarisht nuk është ndonjë detaj teknik por është qëndrim politik. Dhe ky qëndrim krijon një precedent të rrezikshëm, që ligjet hartohen pa autorësi publike dhe pa përgjegjësi.

Sa për rikujtim, Propozim-ligji për arsimin e lartë është dokument zyrtar publik, nuk është opinion personal apo çështje private. Nëse përmbajtja është publike, opinioni ka të drejtë të dijë autorët, sepse transparenca është standard minimal në hartimin e politikave publike, dhe nëse jetojmë në një shoqëri demokratike, kjo nuk duhej të diskutohej fare. Transparenca dhe llogaridhënia janë parimet bazë të një shoqërie demokratike, e cila me sa duket 'nuk jemi'.

Nuk përbën aspak sens që emrat e autorëve që e kanë shkruar ligjin të mbrohen si të dhëna private. Pse do të paditej ministrja nëse i zbulon këto emra? Narrative të tilla krijojnë tendenca serioze për manipulim të opinionit publik duke u thirrur në mekanizma juridike.

Në mungesë përgjigjesh, krijohet hapësirë për dyshime, për ndikime politike, për përzgjedhje të njëanshme të 'ekspertëve', për mungesë përfaqësimi dhe barazie në hartimin e ligjit.

Këtu fillon edhe një problem tjetër dhe më thelbësor. Mostransparenca nuk është vetëm çështje e etikës por është edhe rrezik për përmbajtjen e ligjit. Një proces i mbyllur do prodhojë ligj të mbyllur, pa debat real, pa kritikë të mirëfilltë dhe pa balanc mendimesh. Ndonëse procesi u tentua të 'shitet' si përfshirës, me sa duket përfundimi do jetë ashtu siç do Ministria dhe autorët e saj sekretë.

Madje, edhe vetë reagimet nga akademia dhe shoqëria civile sugjerojnë pikërisht këtë, se konsultimet publike kanë qenë më shumë formale sesa përmbajtësore, apo më mirë thënë një lloj teatri, ku vendimet veç se janë marrë paraprakisht.

Nuk mund të flasim për reformë në arsim duke anashkaluar parimet bazë të transparencës dhe përfshirjes. Nuk mund të kërkosh besim publik, ndërkohë që fsheh informacionin bazë për mënyrën si është hartuar ligji.

Arsimi i lartë në vend ka probleme të thella, kjo është e padiskutueshme. Por ato nuk zgjidhen me improvizime dhe as me procese të mbyllura. Nuk zgjidhen duke kaluar nga A-ja në Zh, duke anashkaluar çdo hap në mes. Reformat serioze kërkojnë proces të hapur, debat real dhe përgjegjësi të qartë. Sepse në fund, një ligj që fillon me sekrete, rrallëherë përfundon në interes publik.

FISNIK XHELILI